



*Të jeni më të hapur në mendimet tuaja,
Të jeni më guximtarë në veprat tuaja,
Të nxitoni më shumë në hapin tuaj.*

Aksion Plus 2013



Ky botim mbështet nga UNFPA




KUSH JEMI NE?

- Ne jemi e vetmja qendër jorezidenciale në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për **trajtimin e përdoruesve të drogës** me Terapi Mbjajtëse me Metadon që nga viti 2005.
- Jemi veçuar si një rast i rrallë edhe në rajon me ofrimin e këtij **shërbimi edhe në burgje e komisariate**, dhe njihemi si një ndërmjetësues mes shtetit dhe përdoruesve edhe në Shërbimin e Provës. **Aksion Plus është e licensuar** nga Ministria e Shëndetësisë, MPCSSHB, QKL, QKEV, si dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin e Provës për shërbime ndaj të dënuarve.
- Ne jemi ata që kujdesemi me **trajtime, manuale, edukim, atelie, publikime, studime e praktika** në institucionet publike. Gjithashtu, jemi të hapur për këdo me ndihmën dhe eksperiencën tonë.
- Aksion Plus njihet edhe për **reduktimin e dëmit** në përdoruesit e drogave dhe grupeve të marginalizuara në **parandalimin e HIV/SIDA-s dhe SST-ve** me informacion, mjete mbrojtëse e shiringa të sterilizuara. Qendra e parë e këtij lloji u hap në vitin 2000.
- **Politikat, strategjitë dhe ligjet për drogën.** Aksion Plus është shumë aktive, duke bashkëpunuar dhe me rrjete rajonale për të përmirësuar ligjet që lidhen me përdorimin e drogës, me fokus dekriminalizimin dhe depenalizimin e përdorimit vetjak të drogës.



ÇFARË PËRPIQËMI TË ARRIMË?

- Të institucionalizohemi si një alternativë potente dhe serioze që promovon parandalimin e SIDA-s, SST-ve, drogat.
- T'i japim përkrahje socializuese dhe integruese grupeve që janë të cënueshme.
- Të ofrojmë shërbime psiko-sociale dhe të tjera shërbime që kanë si qëllim përmirësimin e statusit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të grupeve me të cilat punojmë.



Disa prej projekteve dhe aktiviteteve të AKSION PLUS ndër vite:

- Në vitin **1992** Aksion Plus, e sapohapur, organizoi konferencën e parë kombëtare “A do të harrojë AIDS të vijë në Shqipëri?” në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (MSH).
- Në **2000**-in prezantuam qendrën e parë të Zvogëlimit të Dëmit, një filozofi pragmatiste për përdoruesit e drogave.



- Në vitin **2005** Aksion Plus prezantoi Terapinë Mbjtëse me Metadon (TMM), një terapi shumë e dobishme për përdoruesit problematikë të drogave (licensuar nga MSH). Tashmë qendrat e TMM-së, përveç Tiranës, janë hapur në rrethet: Durrës, Vlorë, Korçë dhe Elbasan, të cilat i shërbejnë rreth 520 klientëve ditorë. Mbështetës: Ministria e Shëndetësisë, UNICEF dhe UNFPA. Kjo terapi filloi pak kohë pas konferencës së parë rreth problemeve të përdoruesve të drogave dhe Terapisë Mbjtëse me Metadon.
- Në **2009**-ën Aksion Plus u bë pjesë e Rrjetit për Shërbimet Komunitare të të Dënuarit të përdoruesve të drogave.
- Në **2010**-ën u hap në Shkodër qendra e Terapisë Mbjtëse me Metadon nga Aksion Plus. Tashmë Aksion Plus ka qendra në Korçë, Elbasan, Tiranë, Fier, Shkodër dhe Durrës.
- Gjithashtu në vitet **2010-2011** një nga projektet ishte dhe ai që lidhej me 'Shërbimin e Provës', ku shumë nga përdoruesit e drogës që kishin kryer shkelje ligjore, me ndërmjetësimin e qendrës sonë kryenin shërbim komunitar pranë nesh në vend të dënimeve të llojeve të tjera. Aktivitetet mbikqyrëse për të dënuarit në Shërbim Prove vazhdojnë. Ky projekt u mbështet nga Komisioni Evropian (bashkëfinancim i OSFA dhe Bankës Botërore).
- Në projektin '**Bota e Nryshimit**' të financuar nga Vodafone Albania, një ish-përdorues droge për 15 vjet, prezantoi veten publikisht dhe eksperiencën e tij në gjimnaze të ndryshme të Shqipërisë.
- Në **2011**-ën u zhvillua projekti nga Ambasada Hollandeze me ndihmën e Qendrës Kombëtare të Shërbimeve Komunitare, mbi shëndetin riprodhues, edukatën seksuale, njohjen dhe parandalimin e HIV/SIDA-s nga të rinjtë në shkolla.
- Gjithashtu, gjatë këtij viti Aksion Plus ka ndërtuar qendrën multifunkionale pas Ambasadës Amerikane me kontributin e prindërve.
- Në **2012**-ën Aksion Plus bashkëorganizoi Konferencën e 6-të të ADRIATIC DRUG ADDICTION TREATMENT dhe simpoziumin e 8-të të Rrjetit të Adriatikut, SEEA, për Varësitë nga Droga në bashkëpunim me Lidhjen Shqiptare të Psikiatrisë.
- Në **2013**-ën Aksion Plus ka vazhduar me seminarët dhe takimet edukuese nëpër shkollat publike për parandalimin dhe sensibilizimin e të rinjve në lidhje me përdorimin e drogave. Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, SIPU dhe DART.

UNFPA - një mbështetje e veçantë

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Planifikim Familjar, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në pothuajse të gjitha projektet e Aksion Plus. Ndihma e saj është e vazhdueshme që prej vitit 2005.

Kjo organizatë merret me probleme të ndryshme lidhur me çështje si: shëndeti riprodhues, lufta kundër HIV/AIDS dhe mbështetja për adoleshentët dhe të rinjtë në mbi 150 vende të botës që prej vitit 1969. Aktivitete të tjera: dhuna në familje, përfshirë dhunën ndaj grave e vajzave dhe dhunën ndaj fëmijëve, punonjëset e seksit, etj. UNFPA jo vetëm trajton, por edhe parandalon me trajnime stafesh, trainerësh dhe sensibilizim.

Më shumë informacion rreth UNFPA mund të gjeni dhe në faqen e website-it të kësaj organizate në <http://www.unfpa.org/public/>.

Ndihmuesit, donatorët dhe partnerët ndër vite

UNICEF, UNFPA, OSH, 'Instituti i Shëndetit Publik', 'Ministria e Financave', IDPC (International Drug Policy Consortium), EHRN (Eurasian Harm Reduction Network), IHRD, SEEA (Adriatic Network on Harm Reduction and Addiction), SWAN (Sex Work Advocacy Network), Komisioni Europian, OSFA dhe Banka Botërore, 'Përthyerje' dhe 'Shelter for Abused Women', Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Drejtësisë, Universitetet 'Luarasi', 'Albanian University' dhe 'Wisdom', 'Vodafone Albania', AMSHC, ICCO, 'Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve', Agjencitë e OKB, SOROS, etj.

Për më shumë informacion mund të vizitoni faqen tonë në internet

www.aksionplus.net www.NCSO-al.org

Cel. 0692066359

Adresa: Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr 1;
Rr. Stavro Vinjau; Prapa Ambasadës Amerikane. Tiranë

E-mail: gencaxionp@albmail.com

also on  